TERMAT e REFERENCËS (TeR)

Subjekti:	**Java e të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) -2026**
Klienti:	DVV International - Kosova
Projekti:	Profesionalizimi i Qendrave të Arsimit për të Rritur në Evropë
Lokacioni:	Disa komuna të ndryshme në Republikën e Kosovës
Afati i fundit për aplikim:	***05 Nëntor, 2026***
Kontakti e-mail adresa:	alija@dvvinternational-ks.net kunushevci@dvvinternational-ks.net

DVV International përfaqëson sektorin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Shoqatës Gjermane për Arsimin e të Rriturve (Deutscher Volkshochschul-Verband e.V.) në Kosovë. Ajo vepron në mbarë botën për të promovuar dhe mbështetur arsimin dhe edukimin e të rriturve si një element kyç për uljen e varfërisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të individëve, komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Me qëllim të promovimit të Arsimit për të Rritur (ARr) dhe Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) në Kosovë, si dhe të sensibilizimit të publikut të gjerë lidhur me përfitimet që arsimi dhe edukimi i vazhdueshëm sjellin për individët, komunitetet dhe shoqërinë, DVV International, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat anëtare të Rrjetit për Arsimin e të Rriturve në Kosovë (ALE NK), po organizon Javën e Mësimit Gjatë Gjithë Jetës në Kosovë, e cila do të mbahet në katër komuna të ndryshme të Kosovës, nga 23 deri më 27 nëntor 2026.

Të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) është një proces i vazhdueshëm që u mundëson individëve të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të reja përmes arsimit formal, joformal dhe informal.

Java e Mësimit Gjatë Gjithë Jetës në Kosovë do të organizohet nga **23 deri më 27 nëntor 2026,** përmes një kombinimi aktivitetesh të ndryshme, duke përfshirë Konferencën Qendrore në Prishtinë, punëtori lokale në disa komuna të tjera të Kosovës, si dhe aktivitete informuese, sensibilizuese dhe mediale, si podkaste, video-incizime etj., në disa komuna të vendit.

Të gjitha aktivitetet e JMGJJ- 2026 do të zhvillohen nga data 23 deri më 27 nëntor 2026.

Përmes aktiviteteve të organizuara në disa komuna të Kosovës, ne do të riafirmojmë se arsimi për të rritur përbërën element kyç të të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ), duke theksuar se praktikat e arsimit për të rritur zbatohen për një gamë të gjerë moshash, nivelesh arsimore, hapësirash dhe modalitetesh të të mësuarit. Gjithashtu, do të theksojmë se MGJJ është motori kryesor i një shoqërie që ofron arsimim dhe edukim në nivele të ndryshme, duke përfshirë individët, familjet, organizatat, vendet e punës, lagjet, qytetet dhe rajonet.

Përshkrimi i detyrave që do të kryhen nga kompania e përzgjedhur, për organizimin e Javës së të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJ- 2026)	***Sasia***	***Nëntor 2026***	***Përgjegjëse***
Roll-Up: 4 në Prishtinë, 1 në Pejë, 1 në Prizren dhe 1 në Vushtrri. Roll-up do të përgatiten për aktivitete të organizuara nga organizatat partnere në ambientet e tyre, si për DVV International Kosova, Kolegji Europian i Kosovës (ECK), Qendra për Arsim në Kosovë (KEC), YALEC Prizren/OJQ THY, YALEC Peja dhe YALEC Vushtrri / OJQ Hareja.	7		Kompania e kontraktuar
Banera (3m x 0.7m): Përgatitja dhe dorëzimi i 2 banerave: 1 për konferencën e DVV International Kosova,1 për Qendrën YALEC Vushtrri.	2		Kompania e kontraktuar
Foldera dhe kimikë me dizajnin e Javës së Mësimit Gjatë Gjithë Jetës (JMGJJ) për konferencën qendrore në Prishtinë (23.11.2026).	120		Kompania e kontraktuar

Infografika dhe materiale vizuale për YALEC Prizren / OJQ THY. Dizajnimi dhe finalizimi i 3 infografikave; Përgatitja e secilës infografikë për shtyp në formatet A3 dhe A4; Shtypja e 15 kopjeve A3 dhe 50 kopjeve A4 për secilën infografikë (gjithsej 45 kopje A3 dhe 150 kopje A4); Përgatitja e versioneve digjitale të infografikave; Përshtatja e materialeve për Instagram Feed dhe Instagram Story; Bashkëpunimi me THY/YALEC dhe përshtatja e dizajneve sipas kërkesave dhe komenteve, deri në miratimin përfundimtar të të gjitha materialeve.	1 pako		
Krijimi i një video promovuese për Nohjen e Mësimit Paraprak (NjMP) në koordinim me Agjencinë e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK).	1 video		

Afati kohor

*Fillimi i përgatitjes së projektit – **Nëntor – 09, 2026,** zbatimi i projektit nga **03 deri më 28 Nëntor 2026.***

Kriteret e përzgjedhjes:

- Të dëshmojë me shkrim përvojën e kompanisë në organizimin e ngjarjeve promovuese në fushën e arsimit, siç janë konferencat, seminaret dhe tryezat e debatit, si dhe në përgatitjen e produkteve vizuale dhe promovuese, siç janë banerat, posterat, Roll-Up, podkastet, video-incizimet etj., për ngjarje të ndryshme edukativo-arsimore, në bashkëpunim me akterë të ndryshëm (nga qeverisja qendrore dhe lokale, organizatat e shoqërisë civile etj.) në Republikën e Kosovës.
- Të dëshmojë se ka një ekip profesional me përvojë për përgatitjen e produkteve të përmendura më lart në të tri gjuhët: shqipe, serbe dhe angleze.
- Të ketë bashkëpunim të mirë me organizatat anëtare të Rrjetit ALE- NK dhe me ofrues të tjerë shtetërorë dhe joshtetërorë të arsimit për të rritur në Kosovë, veçanërisht në komunat e përfshira.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe koordinimi me partnerët relevantë të DVV International, për të cilët do t'i kryejë punët e kontraktuara.
- Të ofrojë një buxhet me kosto të arsyeshme dhe në harmoni me çmimet aktuale në tregun e Kosovës.

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

- Certifikata e regjistrimit dhe CV-ja e kompanisë / organizatës.
- Llogaritja e kostove / buxheti.
- Dëshmi të performances së mëparshme për organizimin e eventeve të ngjajshme edukativo - arsimore në Kosovë, etj .

Të gjitha dokumentet duhet të dërgohen në e-mail adresat: alija@dvvinternational-ks.net , kunushevci@dvvinternational-ks.net , nga data e publikimit të kësaj thirrjeje dhe më së largu deri më ***05 Nëntor 2026.***

Prishtinë / 26 Tetor ,2026